



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 108

Tiranë – E enjte, 28 maj 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Arsimit nr. 8, datë 20.5.2026	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për kriteret dhe procedurat për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, i ndryshuar..... 9579
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 530, datë 15.5.2026	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajes së ruminantëve të vegjël..... 9585
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 536, datë 18.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë... 9586
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 537, datë 18.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 9588
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 545, datë 19.5.2026	Për miratimin e sëmundjeve të listuara, që u nënshtrohen programeve të mbikëqyrjes në vend, shtrirjen gjeografike të këtyre programeve dhe sëmundjet e listuara, për të cilat vendoset statusi i pastër nga sëmundja i ndarjeve..... 9589
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 548, datë 19.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë..... 9590
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 549, datë 19.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Polonisë..... 9591
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 550, datë 19.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë..... 9594

Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 552, datë 20.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës.....	9595
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 553, datë 20.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë.....	9598
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 554, datë 20.5.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë.....	9599
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 634/7, datë 25.5.2026	Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, “Ndërtimi i godinës së parkimit nëntokësor dhe i Parkut Çlodhës, Vlorë”.....	9601
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 717/6, datë 26.5.2026	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 286, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘TEDA’, Tiranë’”.....	9603



UDHËZIM

Nr. 8, datë 20.5.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 21, DATË 15.10.2021,
“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT
PËR NJOHJEN DHE NJËSIMIN NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, TË
DIPLOMAVE, CERTIFIKATAVE,
GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE
AKADEMIKË, TË LËSHUARA NGA
INSTITUCIONE TË HUAJA TË ARSIMIT
TË LARTË DHE INSTITUCIONE TË
TJERA TË AUTORIZUARA”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 6, të nenit 92, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin nr. 21, datë 15.10.2021, “Për procedurat dhe kriteret për njohjen dhe njësimin në Republikën e Shqipërisë, të diplomave, certifikatave, gradave shkencore dhe titujve akademikë, të lëshuara nga institucione të huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar”, i ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë:

a) Nënplotat “i”, dhe “ii”, të shkronjës “b”, të pikës 3, të kreut II, ndryshojnë si më poshtë:

“i. diplomën/certifikatën profesionale ose dokumentin zyrtar përkatës të lëshuar nga institucionet përgjegjëse për lëshimin e kualifikimit në vendin e origjinës, ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të pajisur me vulë apostile dhe/ose legalizim nga vendi i lëshimit të diplomës, të njësuar me origjinalin (noterizuar), si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë;

ii. suplementin (kur lëshohet nga IAL-ja) e diplomës ose listën e notave të njësuar me origjinalin (noterizuar) dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë.”.

b) Pika 3.2 e kreut II, ndryshon si më poshtë:

“3.2 Pas njohjes dhe njësimit të diplomës, QSHA-ja bën llogaritjen e mesatares së vlerësimeve të arritura vetëm me kërkesë të aplikantit brenda 5

(pesë) ditëve pune. Njëvlershmëria e mesatares së vlerësimeve të arritura në shtetin përkatës kryhet për çdo vlerësim/notë që aplikanti ka fituar sipas shtojcës nr. 6, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

Për shtete të tjera që nuk pasqyrohen në tabelë, në shtojcën nr. 6, të këtij udhëzimi, njëvlershmëria bëhet në bazë të informacioneve të marra në faqen zyrtare të rrjetit ENIC-NARIC ose agjenci dhe/ose ente akredituese të IAL-ve të huaja.”.

c) Paragrafi i dytë, i pikës 1, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“Përfundimisht, procedura përfundon brenda 5 ditëve pune nga data e aplikimit, për diploma/certifikata profesionale të të gjitha formave të studimit të fituara në vendet e BE-së dhe SHBA-së, Britani e Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi, në rast se suplementi i diplomës dhe/ose lista e notave të saj janë të pajisura me vulë apostile ose legalizim. Në rastet kur QSHA-ja evidenton parregullsi/mangësi në dokumentacionin e paraqitur, mund të nisë procesin e verifikimit të tij, sipas përcaktimeve të këtij udhëzimi.”.

ç) Paragrafi i fundit, i pikës 1.4, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“Në rastet kur dosja është arkivuar për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit, aplikuesi kryen aplikim të ri sipas kriterëve të përcaktuara në këtë udhëzim, për të cilin nuk kryen pagesë të re për llogari të QSHA-së.”.

d) Shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të pikës 2, të kreut III, ndryshojnë si më poshtë:

“a) kërkon informacion nga IAL-ja vetëm në rastet kur ka dyshim të arsyeshëm ose nga qendrat e rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC–NARIC), dhe institucionet përgjegjëse të shteteve të tjera mbi statusin e institucionit të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, nëse programi i studimit i përfunduar nga aplikanti në një institucion të huaj të arsimit të lartë apo institucion tjetër i autorizuar është i hapur/licencuar si program studimi *online*, me përjashtim të programeve të studimit të përfunduara në institucionet e arsimit të lartë të vendeve BE-së, SHBA-së, Britanisë së Madhe, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi dhe Turqi;



b) i kërkon përmes postës elektronike IAL-së përkatëse dhe nga institucionet e tjera përgjegjëse, sipas rastit, konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe, në rast mospërgjigjeje konfirmimi kërkohej me shkresë zyrtare. Në rast se pas 1 viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e QSHA-së mbi arkivimin e dokumentacionit. Përfshihen nga verifikimi i mëtejshëm i autenticitetit aplikimet me dokumentacion të rregullt dhe me suplementin e diplomës të dorëzuar, për sa kohë institucioni që ka lëshuar diplomën është i njohur në vendin e origjinës dhe diploma është fituar në vendet e BE-së, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Kanada, Japoni, Norvegji, Izrael, Zvicër, Islandë, Australi, si dhe Turqi;

c) kërkon çdo informacion shtesë që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës/certifikatës; i kërkon përmes postës elektronike IAL-së përkatëse konfirmimin e autenticitetit, të paktën dy herë dhe në rast mospërgjigjeje, konfirmimi kërkohej me shkresë zyrtare (dërguar me postë zyrtare). Në rast se pas 1 (një) viti nga momenti i kërkesës së konfirmimit me shkresë zyrtare, ende nuk ka një përgjigje nga IAL-ja, shqyrtimi i aplikimit përkatës ndërpritet dhe dokumentacioni arkivohet në QSHA. Aplikanti njoftohet për vendimin e QSHA-së mbi arkivimin e dokumentacionit.”

dh) Shkronja “a”, e pikës 4, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“a) Diplomati e fituar nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, përpara aplikimit të sistemit të Bolonjës në Shqipëri, për të cilat detyrimet e të gjitha viteve akademike sipas kohëzgjatjes së studimeve janë përmbushur deri në vitin 2010, me kohëzgjatje normale minimale 4 (katër) vite (tetë semestra), me kohë të plotë, të njësohen si ekuivalentët e tyre që ofroheshin në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në të njëjtën periudhë kohore.”.

e) Në pikën 5, të kreut III, togfjalëshi “...nëpërmjet sistemit *online* me nënshkrim dhe vulë elektronike” zëvendësohet me togfjalëshin “nëpërmjet sistemit *online* me vulë elektronike”.

ë) Pika 6, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“6. Për njohjen dhe njësimin e gradave shkencore “Doktor” ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës

për arsimin ose zëvendësministrit të autorizuar prej tij, Komisioni i Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNJG), i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose zëvendësministri i autorizuar prej tij.”.

f) Pika 6.1, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“6.1 KNJG-ja përbëhet nga kryetari dhe katër anëtarë, personel akademik të kategorisë “Profesor”, të caktuar sipas fushave të studimit dhe kërkimit shkencor, të aplikimeve që vlerësohen. Në varësi të këtyre fushave, ndryshohet edhe përbërja e anëtarëve të komisionit.”.

g) Fjala e parë, e pikës 6.3, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“6.3 KNJG-ja mbledhet periodikisht në varësi të numrit të aplikimeve, por jo më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje në vit.”.

gj) Pika 6.4, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“6.4 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit, nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin sipas shtojcës nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Titullari i QSHA-së lëshon njoftimin e vendimit nëpërmjet sistemit *online* me vulë elektronike.”.

h) Pika 7, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“7. Për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit, ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin ose zëvendësministrit të autorizuar prej tij, Komisioni për Njohjen e Titujve Akademikë, anëtarë personel akademik të kategorisë “Profesor”. Komisioni për njohjen e titujve akademikë kryesohet nga ministri përgjegjës për arsimin ose zëvendësministri i autorizuar prej tij dhe përbëhet nga katër anëtarë, të caktuar sipas fushave të studimit dhe kërkimit shkencor të aplikimeve që vlerësohen. Në varësi të këtyre fushave, ndryshohet edhe përbërja e anëtarëve të komisionit.”.

i) Pika 7.1, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“7.1 Sektori i Njohjes së Diplomave në QSHA shërben si sekretariat teknik i komisionit.”.

j) Pika 7.2, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“7.2 Kërkesa për ngritjen e komisionit kryhet nga QSHA-ja, menjëherë pas depozitimit të aplikimit për njohjen e titullit akademik të fituar jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e këtij udhëzimi. “Komisioni për Njohjen e Titujve Akademikë mbledhet periodikisht në varësi të numrit të aplikimeve, por jo më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje në vit.”.

k) Pika 7.3, e kreut III, ndryshon si më poshtë:



“7.3 Në përfundim të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit, kryetari dhe anëtarët e komisionit nënshkruajnë procesverbalin dhe vendimin sipas shtojcës nr. 5, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij. Nëse është vendosur njohja e titullit akademik, titullari i QSHA-së lëshon njoftimin e vendimit nëpërmjet sistemit *online* me vulë elektronike.”.

l) Në pikën 8, të kreut III, togfjalëshi “komisionet *ad hoc* për grada shkencore dhe tituj akademikë...” zëvendësohet me togfjalëshin “Komisioni për Njohjen e Titujve Akademikë...”.

ll) Pika 9, e kreut III, ndryshon si më poshtë:

“9. Vërtetimi i njohjes dhe i njësimit, për diplomat që i përkasin nivelit 5 deri në 8, të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve ose Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (përveç gradave shkencore “Doktor”), lëshohet i firmosur me vulë elektronike nga titullari i QSHA-së në dy kopje (njëra kopje ruhet në protokollin e QSHA-së dhe tjetra ruhet në dosjen e aplikimit përkatës në sistemin elektronik).”.

m) Shkronja “e”, e pikës 12, të kreut III, ndryshon si më poshtë:

“e) numrin dhe datën e vendimit të komisionit;”.

n) Pika 2, e kreut VI, ndryshon si më poshtë:

“2. Aplikanti për njohjen dhe njësimin e gradës shkencore “Doktor” ose njohjen e titullit akademik ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim kundër vendimit të KNJG-së ose Komisionit për Njohjen e Titujve Akademikë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas afateve të parashikuara nga Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë.”.

nj) Shtojcat nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6 zëvendësohen me shtojcat me të njëjtin numër, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Ministrinë e Arsimit, Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe komisionet përkatëse.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT
Mirela Kumbaro Furxhi

Shtojca nr. 1

	FORMULAR APLIKIMI PËR NJOHJE DIPLOME QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE MINISTRIA E ARSIMIT	[QR CODE]
Nëse keni pyetje, lutemi kontaktoni: Email: senjod@qsha.gov.al Web: www.qsha.gov.al	HAPËSIRË E REZERVUAR VETËM PËR INSTITUCIONIN	
<i>Shënim. Ju lutem plotësoni me kujdes dhe qartë informacionin e kërkuar në fushat më poshtë.</i>		

SEKSIONI A: INFORMACION MBI APLIKANTIN

1. Emri	_____	2. Mbiemri	_____
3. Emri i babait	_____	4. NID/nr. i identifikimit personal	□□□□□□□□
5. Gjinia	☐ Mashkull ☐ Femër	6. Datëlindja	□□/□□/□□□□
7. Vendlindja	_____	8. Shtetësia	_____
9. Adresa	_____		
10. Qyteti	_____	11. Bashkia	_____
12. Kodi Postar	□□□□	13. Email-i	_____
14. Nr. tel. celular	_____	15. Nr. tel. fiks	_____

SEKSIONI B: INFORMACION SPECIFIK MBI APLIKIMIN

16. Njohje diplome/titull akademik	☐ Program studimi me karakter profesional pas arsimit të mesëm	☐ Bachelor ☐ Master	☐ Cikël i tretë i studimeve (master ekzekutiv, specializim afatgjatë, doktoratë) ☐ Titull akademik
17. Programi i studimit/titulli akademik që do njihet	_____		



18. Emri i institucionit të arsimit të lartë (IAL)			
19. Pranuar më	□□/□□/□□□□	20. Diplomuar më	□□/□□/□□□□
21. Kohëzgjatja zyrtare (vite)	□□□□	22. Semestra	
23. Niveli i studimeve i kërkuar për pranimin në këtë program studimi	☐ Shkolla e mesme ☐ Bachelor	☐ Cikël i dytë i studimeve (master shkencor/profesional)	☐ Cikël i tretë i studimeve (master ekzekutiv, specializim afatgjatë, doktoratë)
24. Niveli i studimit që mund të ndiqet me diplomën që keni paraqitur kërkesën për njohje	☐ Cikël i dytë i studimeve (master shkencor/profesional)	☐ Cikël i tretë i studimeve (doktoratë) ☐ Post doktoratë	☐ Nuk jep akses në studime të mëtejshme
25. Kontaktet zyrtare të IAL-së, ku jeni diplomuar	Adresa: _____		
	Qyteti _____	Shteti _____	
	Kodi Postar □□□□	Email-i _____	
	Adresa web _____	Nr. tel. fiks _____	

Ky formular është standardizuar nga ADISA AL114012-115

SEKSIONI C: DOKUMENTACIONI I PARAQITUR (VETËM FORMAT PDF-je)

Mënyra e pagesës: Mandat pagese Pagesë *online*

KLAUZOLA DEKLARATIVE

Deklaroj vërtetësinë e të dhënave dhe dokumenteve të paraqitura. Jam i vetëdijshëm se, në rast deklarimi të të dhënave të pavërteta apo të paraqitjes së dokumenteve të falsifikuara apo me të dhëna jo të vërteta, jam subjekt i masave të parashikuara në Kodin Penal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi. Në rast dyshimi për vërtetësinë e informacionit të deklaruar, ministria përgjegjëse për arsimin dhe/ose Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe/ose IAL-ja nisin procedurën e kontrollit të tyre duke ia përcjellë këto të dhëna eventualisht edhe organeve kompetente.

Deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se nuk kam aplikuar më parë për njohje dhe njësim të kësaj diplome pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin apo Qendrës së Shërbimeve Arsimore.

Unë i/e nënshkruari/a _____ në dijeni të përgjegjësiave penale që rrjedhin nga deklarimi dhe paraqitja e të dhënave e rrethanave të rreme, nën përgjegjësinë time personale deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe në respektim të ligjit nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar, autorizoj me vullnetin tim të lirë institucionin, të përpunojë dhe të përdorë të dhënat e mia personale, për qëllime statistikore dhe të shqyrtimit të aplikimit.

Njoftojmë se autorizimi i mëposhtëm është vullnetar.

☐ Autorizoj institucionin të përpunojë të dhënat e mia personale (emër, mbiemër, numër telefoni ose email) të mbledhura më sipër, me qëllim zhvillimin e sondazheve të automatizuara për marrjen e opinionit tim, në lidhje me cilësinë e ofrimit të shërbimit. Autorizoj dhe lejoj institucionin që të kërkojë të dhënat e mia arsimore në institucionin e arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën për të cilën po aplikoj për njohje dhe njësim.

Nënshkrimi i aplikantit _____

Data □□ / □□ / □□□□

Ky formular është standardizuar nga ADISA AL114012-115



Shtojca nr. 2

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
TIRANËFATURË PËR ARKËTIM

Datë _____.____.20____

Me anë të kësaj fature kërkojmë që Banka e Nivelit të Dytë të pranojë nga klientë (persona/persona fizik/persona juridik) arkëtime, për llogari të institucionit tonë, me emërtime, kode, numër identifikimi dhe shuma, si më poshtë:

Emri i institucionit përfitues		Qendra e Shërbimeve Arsimore (QSHA)	
Kodi i institucionit përfitues		1011055	
Kodi i Degës së Thesarit ku vepron		3535	
Emri, Atësia, Mbiemri i paguesit			
ID-ja e detyrimit	Përshkrimi i të ardhurave emërtimi	Kodi i llogarisë ekonomike	Shuma që arkëtohet (lekë)
	Bachelor, master, specializime afatgjata, tituj akademikë dhe doktoratë, të lëshuara nga IAL-të e huaja, për njohje dhe njësime	7110103	2000
X	TOTALI	X	2000

(_____) lekë

TITULLARI I INSTITUCIONIT

KLIENTI

Shtojca nr. 3

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____._____

VËRTETIM NJOHJEJE DHE NJËSIMI

Vërtetohet njohja e diplomës/certifikatës së z./znj. _____ (emër, atësi, mbiemër), lëshuar nga _____ (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), _____ (shteti), më datë _____.____._____ (data e lëshimit të diplomës/certifikatës), me program _____-vjeçar (kohëzgjatja e programit të studimit, _____ ECTS (numri i krediteve të fituara në rast kur këto disponohen), me formë studimi _____ në (emërtimi i programit të studimit).

Kjo diplomë/certifikatë njësohet si _____ në Republikën e Shqipërisë.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën/certifikatën e njohur dhe njësuar.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Shtojca nr. 4

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____._____

VËRTETIM NJOHJEJE DHE NJËSIMI

Z./znj. _____ (emër, atësi, mbiemër) ka fituar gradën shkencore “Doktor” në _____ (fushën e studimit), në institucionin e arsimit të lartë “_____” (institucioni që ka lëshuar diplomën/certifikatën), më _____ (data e fitimit), nëpërmjet paraqitjes së disertacionit me temë: “_____” (titulli i disertacionit).

Në mbështetje të vendimit nr. _____, datë _____.____._____, të Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG) të ngritur me urdhrin nr. _____, datë _____.____._____, “Për ngritjen e Komisionit të Njohjes dhe Njësimit të Gradave Shkencore (KNjG)”, grada shkencore e sipërpërmendur, e fituar në _____ (shteti), nga _____ (emër, atësi, mbiemër) është e barasvlershme me gradën shkencore “Doktor” në Republikën e Shqipërisë.

Grada shkencore “Doktor” i/e z./znj. _____ (emër, atësi, mbiemër) është regjistruar, me numër rendor _____ në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me diplomën e doktoratës.

Shtojca nr. 5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____._____

VËRTETIM I NJOHJES SË TITULLIT AKADEMIK

Z./znj. _____ (emër, atësi, mbiemër) ka fituar titullin akademik “_____” (emërtimin e titullit të fituar), në _____ (fushën e studimit), në institucionin e arsimit të lartë “_____” (institucioni që ka lëshuar titullin akademik), më _____ (data e fitimit të titullit akademik).

Në mbështetje të vendimit nr. _____, datë _____.____._____, të komisionit *ad hoc* të ngritur me urdhrin nr. _____, datë _____.____._____, “Për ngritjen e komisionit *ad hoc* për njohjen e titujve akademikë të fituar jashtë vendit”, titulli akademik i sipërpërmendur, i fituar në _____ (shteti), nga _____ (emër, atësi, mbiemër) është e barasvlershme me titullin akademik “_____” në Republikën e Shqipërisë.

Titulli akademik “_____” i/e z./znj. _____ (emër, atësi, mbiemër) është regjistruar, me numër rendor _____ në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë të fituar jashtë vendit, dhe të mbajtur në Ministrinë e Arsimit.

Ky vërtetim është i vlefshëm, i shoqëruar me dëshminë e titullit akademik.



Shtojca nr. 6

TABELA E NJËVLERSHMËRISË SË NOTAVE								
SHTETI		NOTAT						
Nr .	Shqipëri (ekuivalenti)	4	5	6	7	8	9	10
1	AUSTRALI	0-49	50-52	53-56	57-59	60-69	70-79	85-100
2	FRANCË	<10	10	11	12-13	14	15-16	17-20
3	GJERMANI	4.1-5.0	4	3.8-3.9	3.6-3.7	2.6-3.5	1.6-2.5	1-1.5
4	HOLANDË	0-5	-	6-7.49		7.50-7.99	8-8.49	8.50-10
5	IRLANDË	0-39	40-44	45-49	50-59	60-64	65-69	70-100
6	ITALI	0-17	18-19	20-21	22-23	24-26	27-28	29-30
7	KANADA	0-49	50-52	53-55	56-59	60-69	70-79	80-100
8	MBRETËRIA E BASHKUAR	0-39	40-42	43-45	46-49	50-59	60-69	70-100
9	PORTUGALI	0-9	10-13		14-15		16-17	18-20
10	SHBA	0-59	60-69		70-76	77-82	83-89	90-100
11	SPANJË	0-4.9	5-6.9		7-7.5	7.6-8.2	8.3-8.9	9-10
12	TURQI	0-49	50-64	65-69	70-74	75-79	80-89	90-100
13	ZVICËR	0-4	-	4-4.24	4.25-4.49	4.5-4.75	4.76-5.25	5.26-6
14	GREQI	0-4.9	5-6.49		6.50-7.99		8.00-8.49	8.50-10
15	MAQEDONIA E VERIUT	5	-	6	7	8	9	10
16	KOSOVË	5	-	6	7	8	9	10
17	SERBI	5	-	6	7	8	9	10
18	BULLGARI	2/F	2/FX	3/E	3/D	4/C	5/B	6/A
19	MALI I ZI	5	-	6	7	8	9	10
20	KINA	0-59	60-69		70-79		80-89	90-100
21	RUSIA	2	-	3	-	4	-	5

URDHËR

Nr. 530, datë 15.5.2026

**PËR MARRJEN E MASAVE
KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS SË RUMINANTËVE TË
VEGJËL**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1 dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të ruminantëve të vegjël në tregjet e kafshëve të gjalla, panairë dhe grumbullime të tjera në qarkun Shkodër.

2. Ndalimi i lëvizjes së ruminantëve të vegjël dhe i specieve të tjera të mbarështuara nga ferma në fermë në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

3. Intensifikimin e mbikëqyrjes së popullatave të ruminantëve të vegjël dhe inventarizimin e tyre në zonën e mbrojtur dhe zonën e mbikëqyrjes.

4. Forcimin e masave të biosigurisë.

5. Kafshët e llojit të imta duhet të mbarështohen sipas kërkesave shëndetësore të mbarështimit të tyre, si dhe të jenë të izoluar nga kafshët e tjera në fermë dhe të kufizohet kontakti me kafshët e tjera.

6. Intensifikimin e fushatave të ndërgjegjësimit të fermerëve, transportuesve të kafshëve, veterinerëve privat dhe shërbimit veterinar shtetëror.

7. Intensifikimin e mbikëqyrjes dhe të kontrollit veterinar në fermat që mbarështojnë ruminantë të vegjël dhe tregjet e kafshëve të gjalla në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Zbatimin e masave të tjera të përmendura në urdhrin nr. 802, datë 9.10.2024, “Për miratimin e Planit Kombëtar të Kontigjencës për Sëmundjen e Murtajes së Ruminantëve të Vegjël (PPR)”.

9. Masat e sipërcituara nga pika 2 deri në pikën 6 zbatohen në territorin e:

NJËSIA ADMINISTRATIVE			FSHATI
Nr.			
3 km			
1	Dajç	Mali i Gjymtit	
2.	Dajç	Pentar	
3.	Dajç	Belaj	
4.	Dajç	Suka Dajç	
10 km			
1.	Dajç	Rrushkull	
2.	Dajç	Samrish i Ri	
3.	Dajç	Samrish i Sipërm	
4.	Dajç	Dajç	



5.	Dajç	Mushan
6.	Dajç	Shirq
7.	Dajç	Darragjat
8.	Velipojë	Luarzë
9.	Velipojë	Ças
10.	Velipojë	Baks i Ri
11.	Velipojë	Reç Pulaj
12.	Velipojë	Reç i Ri
13.	Velipojë	Gomsiqe e Re
14.	Velipojë	Pulaj
15.	Velipojë	Velipojë
16.	Velipojë	Mali Kolaj
17.	Bushat	Fshat i Ri
18.	Bushat	Rranxa
19.	Bushat	Plepan
20.	Bërdicë	Trush
21.	Bërdicë	Bërdicë e Madhe
22.	Ana e Malit	Obot
23.	Ana e Malit	Oblikë
24.	Ana e Malit	Muriqan
25.	Ana e Malit	Velinaj
26.	Ana e Malit	Shtuf

10. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar të Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 536, datë 18.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE
ME PATOGJENITET TË LARTË TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) shpendëve dekorativë;
- ç) materialit biologjik të shpendëve;
- d) vezëve të shpendëve;
- dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
- e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Susz*
2.	Warmińsko-Mazurskie	Kętrzyn	Reszel*
3.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Mikstat*
4.	Wielkopolskie	Turek	Kawęczyn*
5.	Wielkopolskie	Turek	Przykona*
6.	Warmińsko-Mazurskie	Ostróda	Grunwald*
7.	Wielkopolskie	Konin	Rzgów*
8.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Pozezdrze*
9.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Ilawa (rural)*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Zalewo*
11.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
12.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
13.	Lubuskie	Międzyrzecz	Skwierzyna*
14.	Warmińsko-Mazurskie	Bartoszyce	Bartoszyce (rural)*
15.	Lubuskie	Sulęcín	Krzeszyce*
16.	Mazowieckie	Białobrzegi	Stara Błotnica*
17.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Gniewkowo*
18.	Opolskie	Namysłów	Pokój*
19.	Kujawsko-Pomorskie	Chełmno	Lisewo*
20.	Lubuskie	Świebodzin	Lubrza*
21.	Lubuskie	Gorzów	Deszczno*
22.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
23.	Warmińsko-Mazurskie	Nidzica	Janowiec Kościelny*
24.	Warmińsko-Mazurskie	Węgorzewo	Węgorzewo*
25.	Mazowieckie	Żuromin	Lutocin*
26.	Pomorskie	Kartuzy	Somonino*
27.	Łódzkie	Poddębice	Pęczniew*
28.	Pomorskie	Ślupsk	Kobylnica*
29.	Wielkopolskie	Kalisz	Szczytniki*
30.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
31.	Lubuskie	Żagań	Malomice*
32.	Lubuskie	Gorzów	Bogdaniec*
33.	Lubelskie	Parczew	Siemien*
34.	Lubelskie	Radzyń Podlaski	Wohryn*
35.	Lubelskie	Biała Podlaska	Międzyrzec Podlaski (rural)*
36.	Podlaskie	Hajnówka	Narew*
37.	Mazowieckie	Mława	Szydłowo*
38.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*



39.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Ostrów Wielkopolski (rural)*
40.	Lubuskie	Gorzów	Lubiszyn*
41.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemet*
42.	Wielkopolskie	Turek	Brudzew*
43.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
44.	Pomorskie	Kartuzy	Sulęcyno*
45.	Wielkopolskie	Śrem	Brodnica*
46.	Śląskie	Pszczyna	Pszczyna*
47.	Wielkopolskie	Turek	Władysławów*
48.	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Rogowo*
49.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
50.	Zachodniopomorskie	Stargard	Dobrzany*
51.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
52.	Dolnośląskie	Legnica	Prochowice*
53.	Wielkopolskie	Ostrzeszów	Grabów Nad Prosną*
54.	Kujawsko-Pomorskie	Lipno	Lipno (rural)*
55.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Janikowo*
56.	Warmińsko-Mazurskie	Giżycko	Giżycko (rural)*
57.	Wielkopolskie	Chodzież	Margonin*
58.	Kujawsko-Pomorskie	Inowrocław	Kruszwica*
59.	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Lwówek*
60.	Wielkopolskie	Leszno	Włoszakowice*
61.	Lódzkie	Brzeziny	Jeżów*
62.	Mazowieckie	Żuromin	Biezuń*
63.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
64.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
65.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
66.	Mazowieckie	Mława	Radzanów*
67.	Mazowieckie	Mława	Strzegowo*
68.	Mazowieckie	Żuromin	Kuczbork-Osada*
69.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
70.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
71.	Mazowieckie	Płońsk	Baboszewo*
72.	Wielkopolskie	Kalisz	Brzeziny*
73.	Pomorskie	Starogard	Skarszewy*
74.	Mazowieckie	Mława	Stupsk*
75.	Lubuskie	Żary	Żary*
76.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
77.	Kujawsko-Pomorskie	Golub-Dobrzyń	Kowalewo Pomorskie*
78.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Razków*
79.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Nowe Miasto Lubawskie (rural)*
80.	Mazowieckie	Sierpc	Gozdowo*
81.	Lubelskie	Biała Podlaska	Drelów*
82.	Dolnośląskie	Wrocław	Długoleka*
83.	Mazowieckie	Płock	Stara Biała*
84.	Mazowieckie	Płock	Bielsk*
85.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Purda*
86.	Kujawsko-Pomorskie	Brodnica	Bartniczka*
87.	Lódzkie	Zgierz	Aleksandrów Łódzki*
88.	Mazowieckie	Żuromin	Lubowidz*
89.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Rybno*
90.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
91.	Wielkopolskie	Pleszew	Gofuchów*
92.	Wielkopolskie	Jarocin	Kotlin*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuar para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 526, datë 15.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Fatmir Guri



URDHËR

Nr. 537, datë 18.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;

b) zogjve 24-orësh;

c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kripasë nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

i. 65°C në 39.8 sekonda;

ii. 70°C në 3.6 sekonda;

iii. 74°C në 0.5 sekonda;

iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1	Malopolskie	Brzesko	Czchów*
2	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5	Podlaskie	Białystok	Łapy*

6	Malopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8	Malopolskie	Bochnia	Bochnia*
9	Podkarpackie	Przemyśl	Krasieczyn*
10	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Ilowo-Osada*
11	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15	Mazowieckie	Wolomin	Thuszcz*
16	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17	Malopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21	Mazowieckie	Zuromin	Bieżuń*
22	Mazowieckie	Zuromin	Zuromin*
23	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Miedzichowo*
46	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50	Wielkopolskie	Nowy Tomyśl	Opalenica*
51	Malopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53	Wielkopolskie	Szamotuły	Duszniki*
54	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*
56	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytów*
60	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osięciny*
65	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminek*
67	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*



68	Łódzkie	Skierniewice	Lipce Reymontowskie*
69	Łódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyńskie*
72	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73	Łódzkie	Łowicz	Zduny*
74	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78	Zachodniopomorskie	Kamień	Golczewo*
79	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85	Śląskie	Mikolów	Mikolów*
86	Mazowieckie	Mława	Szczytno*
87	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88	Lubuskie	Sulęcin	Krzyszów*
89	Łódzkie	Sieradz	Wróblew*
90	Opolskie	Olesno	Zębowice*
91	Małopolskie	Wieliczka	Wieliczka*
92	Śląskie	Cieszyn	Hazlach*
93	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
94	Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
95	Kujawsko-Pomorskie	Sępólno	Sośno*
96	Zachodniopomorskie	Gryfice	Gryfice*
97	Kujawsko-Pomorskie	Brodnica	Świdwiebia*
98	Kujawsko-Pomorskie	Żnin	Żnin*
99	Kujawsko-Pomorskie	Mogilno	Jeziora Wielkie*
100	Pomorskie	Sztum	Sztum*
101	Pomorskie	Bytów	Studzienice*
102	Pomorskie	Człuchów	Przechlewo*
103	Wielkopolskie	Oborniki	Oborniki*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinarë garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve,

për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 527, datë 15.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR¹
Nr. 545, datë 19.5.2026

PËR MIRATIMIN E SËMUNDJEVE TË LISTUARA, QË U NËNSHTROHEN PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES NË VEND, SHTRIRJEN GJEOGRAFIKE TË KËTYRE PROGRAMEVE DHE SËMUNDJET E LISTUARA, PËR TË CILAT VENDOSËT STATUSI I PASTËR NGA SËMUNDJA I NDARJEVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 30,

¹ Ky urdhër është përafëruar plotësisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (BE) 2020/690 e datës 17 dhjetor 2019, që përcakton rregullat për zbatimin e Rregullores (BE) 2016/429 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, në lidhje me sëmundjet e listuara që u nënshtrohen programeve të

mbikëqyrjes së Bashkimit Evropian, shtrirjen gjeografike të programeve të tilla dhe sëmundjet e listuara, për të cilat vendoset statusi i pastër nga sëmundja i ndarjeve, FZ L 174, datë 3.6.2020, f. 341–344.



dhe pikës 1, të nenit 37, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”,

URDHËROJ:

Neni 1

Sëmundjet e listuara që u nënshtrohen programeve të mbikëqyrjes në Republikën e Shqipërisë në përputhje me nenin 28, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, dhe shtrirja gjeografike e programeve të tilla përcaktohet në shtojcën I të këtij urdhri.

Neni 2

Sëmundjet e listuara për të cilat vendoset statusi i pastër nga sëmundja i ndarjeve në përputhje me nenin 37, të ligjit nr. 41, datë 26.6.2025, “Për shëndetin e kafshëve”, janë përcaktuar në shtojcën II të këtij urdhri.

Neni 3

Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe fillon të zbatohet nga data 11.7.2027.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

SHTOJCA I

SËMUNDJET E LISTUARA QË U NËNSHTROHEN PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES	SHTRIRJA GJEORAFIKE E PROGRAMEVE TË MBIKËQYRJES
Gripi i shpendëve me patogjenitet të lartë	I gjithë territori i vendit
Infeksioni me viruse të gripit të shpendëve me patogjenitet të ulët	I gjithë territori i vendit

SHTOJCA II

SËMUNDJET E LISTUARA PËR TË CILAT VENDOSËT STATUSI I PASTËR NGA SËMUNDJA I NDARJEVE
Nekroza hematopoietike epizootike
Septicemia hemorragjike virale
Nekroza hematopoietike infektive
Infeksioni me rajonin shumë polimorf (HPR) fshihet me virusin e anemisë infektive të salmonit
Infeksion me <i>Microcytos mackini</i>
Infeksion me <i>Perkinsus marinus</i>
Infeksion me <i>Bonamia ostreae</i>
Infeksion me <i>Bonamia exitiosa</i>
Infeksion me <i>Marteilia refringens</i>
Infeksion me virusin e sindromës Taura
Infeksion me virusin e kokës së verdhë
Infeksion me virusin e sindromës së njollave të bardha
Gripi i shpendëve me patogjenitet të lartë
Infeksioni me virusin e sëmundjes së Pseudopestit

URDHËR

Nr. 548, datë 19.5.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E GJERMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- zogjve 24-orësh;
- mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e



vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve të shfaqur në shtetin e Gjermanisë janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Bayern	Erding	Steinkirchen*
2.	Brandenburg	Oder-Spree	Neuzelle*
3.	Bayern	Erding	Bockhorn*
4.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Bestensee*
5.	Bayern	Mühlendorf am Inn	Neumarkt-Sankt Veit*
6.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Königs Wusterhausen*
7.	Bayern	Rottal-Inn	Gangkofen*
8.	Brandenburg	Spree-Neiße	Neuhausen/Spree*
9.	Brandenburg	Oder-Spree	Spreehagen*
10.	Brandenburg	Oder-Spree	Storkow (Mark)*
11.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Seelow-Land*
12.	Brandenburg	Dahme-Spreewald	Mittenwalde*
13.	Bayern	Landshut	Vilsbiburg*
14.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Barnim-Oderbruch*
15.	Brandenburg	Märkisch-Oderland	Golzow*
16.	Bayern	Erding	Oberding*
17.	Bayern	Mühlendorf am Inn	Buchbach*
18.	Bayern	Mühlendorf am Inn	Oberbergkirchen*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Gjermanisë të cilat nuk kanë pasur njoftim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin

Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të

shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 460, datë 28.4.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit, të shfaqur në shtetin e Gjermanisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 549, datë 19.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Zachodniopomorskie	Choszczno	Pełczyce*
Zachodniopomorskie	Choszczno	Recz*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Polonisë të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin

janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujt 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.



2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime

eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e



përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 491, datë 7.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin Polonisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR

Nr. 550, datë 19.5.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE TË DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E RUMANISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Muresh	Voivodeni*
2.	Muresh	Vatava*
3.	Muresh	Zau De Campie*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 478, datë 4.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të



dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 552, datë 20.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE
TË DERRAVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E UKRAINËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, duke përfshirë mishin në një kontenier të vulosur (mbyllur) hermetikisht me një vlerë të F_0 prej 3 ose më lart, xhelatinën, ushqimin e thatë të kafshëve shtëpiake, dhe vakteve proteinike, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe ADIS-ës, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Chernihiv	Ripkyns'kyi*	
Chernihiv	Chernivets'ka*	

Chernihiv	Nizhyns'kyi*	
Chernihiv	Kozelets'kyi*	
Chernihiv	Pryluts'kyi*	
Chernihiv	Nosivs'kyi*	
Chernihiv	Sribnians'kyi*	
Chernihiv	Mens'kyi*	
Chernivtsi	Hlybts'kyi*	
Chernivtsi	Sokyrians'kyi*	
Chernivtsi	Storozhynets'kyi*	
Chernivtsi	Zastavnets'kyi*	
Cherkasy	Smilians'kyi*	
Cherkasy	Cherkas'kyi*	
Dnipropetrovs'k	Mahdalynivs'kyi*	
Donets'k	Slovians'kyi*	
Donets'k	Krasnolymans'kyi*	
Donets'k	Velykonovosilkiys'kyi*	
Kharkiv	Krasnokuts'kyi*	
Kharkiv	Novovodolaz'kyi*	
Kharkiv	Valkivs'kyi*	
Kiev	Obukhivs'kyi*	
Kiev	Vyshhorods'kyi*	
Kiev	Boryspil's'ka*	
Kiev	Ivankivs'kyi*	
Kiev	Holosivs'kyi*	
Kiev	Rokytnians'kyi*	
Kiev	Pereiaslav-Khmel'nyts'kyi*	
Kiev	Bilotserkivs'kyi*	
Kiev	Baryshivs'kyi*	
Kiev	Kaharlyts'kyi*	
Kiev	Iahotyns'kyi*	
Kiev	Tarashchans'kyi*	
Kiev	Myronivs'kyi*	
Kirovohrad	Dobrovelychkivs'kyi*	
Kirovohrad	Kirovohrads'kyi*	
Kirovohrad	Novomyrhorods'kyi*	
Kirovohrad	Novoukrans'kyi*	
Kirovohrad	Oleksandriis'kyi*	
Kirovohrad	Petrivs'kyi*	
Kirovohrad	Svitlovods'kyi*	
Kirovohrad	Znamians'kyi*	
Zhytomyr	Chudnivs'kyi*	
Zhytomyr	Zhytomyrs'ka*	
Zhytomyr	Berdychivs'kyi*	
Volyn	Volodymyr-Volyns'kyi*	
Kherson	Beryslavs'kyi*	
Kherson	Novovorontsovs'kyi*	
Kherson	Velykooleksandrivs'kyi*	
L'viv	Zhovkivs'kyi*	
Mykolayiv	Mykolaivs'kyi*	
Mykolayiv	Berezans'kyi*	
Mykolayiv	Berezhnivats'kyi*	
Mykolayiv	Kazanetskyi*	
Mykolayiv	Kryvozers'kyi*	
Mykolayiv	Novobuz'kyi*	
Mykolayiv	Vradiivs'kyi*	
Odessa	Kotovs'kyi*	
Odessa	Izmad's'ka*	
Odessa	Bilhorod-Dnistrovs'kyi*	
Odessa	Bilavcs'kyi*	
Poltava	Hlobyns'kyi*	
Poltava	Khorol's'kyi*	
Poltava	Kobelivs'kyi*	
Poltava	Kozel'shchyns'kyi*	



Poltava	Poltavs'kyi*	
Poltava	Semenivs'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Kolomyis'kyi*	
Ivano-Frankivs'k	Rozhniativs'kyi*	
Sumy	Konotops'kyi*	
Sumy	Krolevets'kyi*	
Sumy	Lebedyns'kyi*	
Sumy	Nedryhailivs'kyi*	
Sumy	Romens'kyi*	
Sumy	Sums'kyi*	
Vinnysya	Bershad's'kyi*	
Vinnysya	Iampil's'kyi*	
Vinnysya	Illinets'kyi*	
Vinnysya	Lityns'kyi*	
Vinnysya	Lypovets'kyi*	
Vinnysya	Tul'chyns'kyi*	
Zaporizhzhya	Orikhivs'kyi*	

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, mishin e freskët dhe produktet e tij, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Ukrainës, të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1. Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:**

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, ose;

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj

vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) sperma e përdorur për fekundimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:**

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilën janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajes afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstroi dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve.

2.4. Për mishin e freskët të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër të mbajtur, **certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:**

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenin 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të



Kafshëve dhe vërteton se asnjë rast i sëmundjes së murtajës afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave në përputhje me pikën 1 ose pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas ngordhjes në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) janë përgatitur nga mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me nenin 15.1.23 të

Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) e kanë origjinën nga derrat e egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, **certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetohet që:**

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zonë të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

b) origjinojnë nga derra të egër të mbajtur ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartment pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ose;

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve të Tokës të Organizatës Botërore të Shëndetit të Kafshëve dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve



informojnë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

4. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

6. Urdhri nr. 305, datë 19.3.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajës afrikane të derrave, të shfaqur në shtetin e Ukrainës”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 553, datë 20.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË LISË SË DHENVE DHE
TË DHIVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN
E RUMANISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e pikës 2.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2*
1.	Mureş	Voivodeni*
2.	Mureş	Vatava*
3.	Mureş	Zau De Campie*
4.	Mureş	Suseni*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojë të gjitha subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi, materialit biologjik, leshit dhe lëkurës të kafshëve të llojit dhen dhe dhi për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Urdhri nr. 550, datë 19.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së lisë së dhenve dhe të dhive, të shfaqur në shtetin e Rumanisë”, shfuqizohet.

7. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.



Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

URDHËR
Nr. 554, datë 20.5.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË PSEUDOPESTIT TË
SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË
SHTETIN E POLONISË**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

- a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
- b) zogjve 24-orësh;
- c) mishit të freskët;

ç) materialit biologjik të shpendëve të pashoqëruar me test diagnostik PCR të kryer 14 ditë përpara mbledhjes, që vërteton mosprezencën e virusit;

d) vezëve dhe produktet e vezëve të shpendëve, ku nuk është siguruar shkatërrimi i virusit të pseudopestit, përkatësisht në vezën e plotë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 55°C në 2,521 sekonda, në vezën e lëngshme nuk është bërë trajtimi në 55°C në 2,278 sekonda, në të verdhën e vezës me 10% kriposje nuk është bërë trajtimi me temperaturë 55°C në 176 sekonda dhe në të bardhën e vezës së tharë nuk është bërë trajtimi në temperaturën 57°C në 50.4 orë;

dh) produktet e mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht përkatësisht:

- i. 65°C në 39.8 sekonda;
- ii. 70°C në 3.6 sekonda;
- iii. 74°C në 0.5 sekonda;
- iv. 80°C në 0.03 sekonda;

e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e pseudopestit të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Polonisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Małopolskie	Brzesko	Czchów*
2.	Śląskie	Gliwice (City)	Gliwice*
3.	Śląskie	Gliwice	Toszek*
4.	Podlaskie	Siemiatycze	Nurzec-Stacja*
5.	Podlaskie	Białystok	Łapy*
6.	Małopolskie	Tarnów	Wojnicz*
7.	Kujawsko-Pomorskie	Toruń	Chelmża (rural)*
8.	Małopolskie	Bochnia	Bochnia*
9.	Podkarpackie	Przemyśl	Krasiczyn*
10.	Warmińsko-Mazurskie	Działdowo	Iłowo-Osada*
11.	Podlaskie	Białystok	Supraśl*
12.	Lubelskie	Łęczna	Ludwin*
13.	Pomorskie	Nowy Dwór Gdański	Ostaszewo*
14.	Świętokrzyskie	Jędrzejów	Sędziszów*
15.	Mazowieckie	Wołomin	Tłuszcz*
16.	Podkarpackie	Przemyśl	Stubno*
17.	Małopolskie	Bochnia	Nowy Wiśnicz*
18.	Świętokrzyskie	Staszów	Staszów*
19.	Podkarpackie	Przemyśl	Medyka*
20.	Pomorskie	Malbork	Miloradz*
21.	Mazowieckie	Żuromin	Bieżuń*
22.	Mazowieckie	Żuromin	Żuromin*
23.	Łódzkie	Piotrków	Wolbórz*
24.	Łódzkie	Rawa	Rawa Mazowiecka (rural)*
25.	Pomorskie	Kartuzy	Sierakowice*
26.	Mazowieckie	Gostynin	Gostynin (rural)*
27.	Mazowieckie	Sierpc	Szczutowo*
28.	Mazowieckie	Sierpc	Rościszewo*
29.	Podkarpackie	Mielec	Radomyśl Wielki*
30.	Świętokrzyskie	Kielce	Mniów*
31.	Podlaskie	Mońki	Goniądz*
32.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Wolsztyn*
33.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Nowe Skalmierzyce*
34.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Zakrzewo*
35.	Lubuskie	Wschowa	Wschowa*
36.	Wielkopolskie	Poznań	Stęszew*
37.	Wielkopolskie	Leszno	Wijewo*
38.	Zachodniopomorskie	Białogard	Białogard (rural)*
39.	Podlaskie	Mońki	Knyszyn*
40.	Podlaskie	Sokółka	Janów*
41.	Opolskie	Opole	Niemodlin*
42.	Warmińsko-Mazurskie	Olsztyn	Jonkowo*
43.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Przemęt*
44.	Wielkopolskie	Wolsztyn	Siedlec*
45.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Miedzichowo*
46.	Wielkopolskie	Rawicz	Miejska Górka*
47.	Wielkopolskie	Grodzisk Wielkopolski	Grodzisk Wielkopolski*
48.	Zachodniopomorskie	Gryfino	Gryfino*
49.	Wielkopolskie	Ostrów Wielkopolski	Sieroszewice*
50.	Wielkopolskie	Nowy Tomysl	Opalenica*
51.	Małopolskie	Dąbrowa	Olesno*
52.	Podlaskie	Mońki	Krypno*
53.	Wielkopolskie	Szamotuly	Duszyniki*
54.	Wielkopolskie	Poznań	Mosina*
55.	Mazowieckie	Maków	Plonawy-Bramura*



56.	Zachodniopomorskie	Koszalin	Sianów*
57.	Wielkopolskie	Kalisz	Opatówek*
58.	Wielkopolskie	Kalisz	Lisków*
59.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Bytów*
60.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Nowe Miasto Nad Wartą*
61.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Kurzętnik*
62.	Wielkopolskie	Kalisz	Ceków-Kolonia*
63.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Zaniemyśl*
64.	Kujawsko-Pomorskie	Radziejów	Osiężyn*
65.	Dolnośląskie	Milicz	Krośnice*
66.	Wielkopolskie	Kalisz	Koźminiek*
67.	Warmińsko-Mazurskie	Ilawa	Lubawa (rural)*
68.	Lódzkie	Skiermiewice	Lipce Reymontowskie*
69.	Lódzkie	Sieradz	Goszczanów*
70.	Wielkopolskie	Śrem	Śrem*
71.	Wielkopolskie	Leszno	Rydzyn*
72.	Warmińsko-Mazurskie	Nowe Miasto	Biskupiec*
73.	Lódzkie	Łowicz	Zduny*
74.	Wielkopolskie	Szamotuły	Kaźmierz*
75.	Wielkopolskie	Pleszew	Goluchów*
76.	Mazowieckie	Płock (City)	Płock*
77.	Lubuskie	Nowa Sól	Bytom Odrzański*
78.	Zachodniopomorskie	Kamień	Golezów*
79.	Wielkopolskie	Gostyń	Poniec*
80.	Śląskie	Dąbrowa Górnicza	Dąbrowa Górnicza*
81.	Lubuskie	Nowa Sól	Kożuchów*
82.	Wielkopolskie	Konin	Skulsk*
83.	Lubuskie	Zielona Góra	Nowogród Bobrzański*
84.	Lubuskie	Nowa Sól	Nowa Sól (rural)*
85.	Śląskie	Mikołów	Mikołów*
86.	Mazowieckie	Mława	Szreńsk*
87.	Kujawsko-Pomorskie	Aleksandrów	Aleksandrów Kujawski (rural)*
88.	Lubuskie	Sulęcín	Krzyszczewo*
89.	Lódzkie	Sieradz	Wróblew*
90.	Opolskie	Olesno	Zębowice*
91.	Małopolskie	Wieliczka	Wieliczka*
92.	Śląskie	Cieszyn	Hażlach*
93.	Wielkopolskie	Środa Wielkopolska	Środa Wielkopolska*
94.	Zachodniopomorskie	Kołobrzeg	Dygowo*
95.	Kujawsko-Pomorskie	Sępólno	Sośno*
96.	Zachodniopomorskie	Gryfice	Gryfice*
97.	Kujawsko-Pomorskie	Brodnica	Świdziebna*
98.	Kujawsko-Pomorskie	Znin	Żnin*
99.	Kujawsko-Pomorskie	Mogilno	Jeziora Wielkie*
100.	Pomorskie	Sztum	Sztum*
101.	Pomorskie	Bytów	Studzienice*
102.	Pomorskie	Człuchów	Przechlewo*
103.	Wielkopolskie	Oborniki	Oborniki*
104.	Kujawsko-Pomorskie	Tuchola	Tuchola*
105.	Kujawsko-Pomorskie	Bydgoszcz	Koronowo*
106.	Wielkopolskie	Piła	Białośliwie*

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Importi dhe tranzitimi i shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve, lejohet nga zona dhe kompartamente të shtetit të Polonisë, të cilat nuk

kanë pasur njofim të sëmundjes së pseudopestit të shpendëve për 12 muajt e fundit.

4. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, mishit të freskët, materialit biologjik, vezëve dhe produkteve të vezëve, produktet e mishit të shpendëve dhe nënprodukteve të shpendëve që vijnë nga zonat e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve të informojnë të gjithë subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

7. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 537, datë 18.5.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së pseudopestit të shfaqur në shtetin e Polonisë”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ME URDHËR DHE DELEGIM
ZËVENDESMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri

**KËRKESË****Nr. 634/7, datë 25.5.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, ‘Ndërtimi i godinës së parkimit nëntokësor dhe i Parkut Çlodhës, Vlorë’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 7,228,689 (shtatë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasurinë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e

Shqipërisë”, për pasurinë e llojit “truall”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 7,228,689 (shtatë milionë e dyqind e njëzet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I GODINËS SË PARKIMIT NËNTOKËSOR DHE I PARKUT ÇLODHËS, VLORË”

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Të dhënat e pasurisë			Tokë "truall"				Tokë "arë"				Ndërtesë soc.-ek			Objekt banimi				Vlera totale (lekë)	Shënime	Adresa e pronarëve
				Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivit (lekë)	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi m²	Vlera (lekë)			
1	Manushage	Xhafer	Abazi	8602	33/12-T	Truall	400	400	10,903	4,361,200											4,361,200.00	Seksioni D-mangon shica e vendimit të gjykatës, si dhe certifikata e trupat familjar të Kozma Thanas dhe Josif Dodit. Nuk kanë firmosur të gjithë bashkëpronarët në shitje, seksioni E - e vlefshme për shpronësim.	Bashkia Vlorë	
	Mezan	Safer	Abazi																					
	Ilirija	Safer	Abazi																					
	Arbi	Safer	Abazi																					
	Arbela	Safer	Abazi																					
2	Manushage	Xhafer	Abazi	8602	33/23	Truall	800	263	10,903	2,867,489											2,867,489.00	Seksioni D-mangon shica e vendimit të gjykatës, si dhe certifikata e trupat familjar të bashkëpronarëve të trashëgimtarëve të seksionit E - e vlefshme për shpronësim.	Bashkia Vlorë	
	Mezan	Safer	Abazi																					
	Ilirija	Safer	Abazi																					
	Arbi	Safer	Abazi																					
	Arbela	Safer	Abazi																					
3	Shtet	Shtet	Shtet	8602	28/149	Truall	6201	1593													Seksioni E-29 m² vijonë në pas. me nr. 28/80/1, v. 119, f. 201			
4	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/28	Truall	2066	282														Seksioni C-VKM Nr 265 dt 09/05/2025 për të drejtën e administrimit/përdonimit-Fondi Shqiptar I Zhvillimit.		
5	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/25	Truall	730	28.5														Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdonimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.		
6	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/29	Truall	426	426														Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdonimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.		
7	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/34	Truall	6142	6142														Seksioni C-VKM-ja nr. 265 datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdonimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.		
8	Shtet	Shtet	Shtet	8602	33/33/1	Truall	1066.7	1066.7														Seksioni C-VKM-ja nr. 265, datë 9.5.2025 për të drejtën e administrimit/përdonimit-Fondi Shqiptar i Zhvillimit.		
SHUMA TOTALE																						7,228,689.00		

**KËRKESË****Nr. 717/6, datë 26.5.2026****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 286, datë 17.5.2023, të Këshillit të Ministrave, ‘Për shpronësim, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Zona e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik ‘TEDA’, Tiranë’”, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 6,797,952 (gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, me efekt financiar shtesë 4,199,552 (katër milionë e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Vlerësimi për pasuritë e llojit “arë” është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Tiranë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 6,797,952 (gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e dy) lekë, me efekt financiar shtesë 4,199,552 (katër milionë e njëqind e nëntëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI “PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 286, DATË 17.5.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR SHPRONËSIM, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTI ‘ZONA E TEKNOLOGJISË DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK ‘TEDA’, TIRANË’”

Nr.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKARE									VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						SHËNIME (kufizime hipotekare barre mbi pasurinë etj.)	
	Emër	Atësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Tnall (m²)	Ndërtesë (m²)	Vol.	Faqe	Arë			NDËRTESE				VLERA TOTALE (lekë)
													Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
A	B	C	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	R	S	T	U	V
Zvogëlim sipërfaqe në VKM-në nr. 286, datë 17.5.2023																				
41	Tahir	Ramazan	Gjokmeli	Tiranë	1867	23/17	Arë	4800	-	-	2	92	4800	448	2,150,400	-	-	-	2,150,400	Konfirmuar nga ASHK-ja: Diferenca e sipërfaqes së pasurisë fakt-dok. është 1000 m². Të dhënat e pasurisë janë përmirësuar /përditësuar, sipas nenit 64, të ligjit 33/2012, më datë 6.10.2018. Shënim SSH: kjo pasuri është shpronësuar me VKM-në nr. 286, datë 17.5.2023, për sipërfaqen 5800 m², kur realisht sipërfaqja totale dhe sipërfaqja e prekur e pronës është 4800 m². Pasuria ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tiranë tashmë, ku në përgjigje të aplikimit 8017, datë 13.3.2026, konfirmohet me sipërfaqe të përgjithshme 4800 m², në pronësi të Bashkisë Tiranë. Shënuar në pronësi të pronarit, me qëllim kryerjen e likuidimit të vlerës së shpronësimit.
Pasuritë që shtohen në VKM-në nr. 286, datë 17.5.2023																				
65	Maniola	Shaqir	Çausi	TIRANË	3866	116/10	ARË	4200	-	-	1	139	4200	448	1,881,600	-	-	-	1,881,600	Naze Çausi, pjesëtar sipas certifikatës familjare të vitit 1991 të dhënat e pasurisë janë përmirësuar



																			dhe përditësuar, sipas nenit 64 të ligjit 33/2012, më datë 31.8.2018, 1495	
66	Arjan Rukije Alma	Sefer Mehmet Sefer	Çausi Çausi Lami	TIRANË	3866	116/43	ARE	4625	-	-	71	191	4625	448	2,072,000	-	-	-	2,072,000	
67	Ridvan Myzafer Trendafil Resmije Elida Enverie Flamure Wilson	Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber Kamber	Miloshi Miloshi Miloshi Petriti Karaj Ymer Zere Miloshi	TIRANË	3866	116/38	ARE	512	-	-	143	173	512	448	229,376	-	-	-	229,376	Kamber Milloshi, të dhënat e pasurisë janë përmirësuar /përditësuar sipas nenit 64 të ligjit 33/2012, më datë 6.10.2018
68	Ismail	Tahir	Egra	TIRANË	2105	562/11	ARE	1037	-	-	31	104	1037	448	464,576	-	-	-	464,576	Sipas urdhrit të ASHK Tirana Rurale 2, u ndryshua nr. i vol. faqes urdhri nr. 151, datë 17.2.2025
SHUMA PARAPRAKE													15174		6,797,952			-	6,797,952	
EFEKTI FINANCIAR													9374		4,199,552			-	4,199,552	



Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 128 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË[Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare]Viti: 2026 - Numri: 108]Datë: 28.05.2026 14:50:42
+02:00]c14971d7-0505-4ca2-b501-fb502007e488

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)